Për: **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr[1] i prokurimit	**328-26-4498-5-1-1**
Nr i brendshëm	**33300/026/023/511**

Sa i përket tenderit për: "**Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Prizren-Faza e Dytë"**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

O.E."EING COM" SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Fsh Dumosh – Podujevë, 11000
(Vendi, Kodi postar)

+383 49 263 052
(Numri Telefonit)

Eljesah PODVORICA
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@eing-ks.com
(Adresa elektronike)

09.11.2026
(Data e parashtrimit të kërkesës)

2. Identifikimi i avokatit

Ankesa parashtrohet nga përfaqësuesi i autorizuar i OE "EING COM" SH.P.K.

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- 02.07.2026 – Data e publikuar e Njoftimit për Kontratë
- 09.09.2026 –Afati i fundit për Dorëzimin e Tenderëve
- 23.10.2026 - Kërkes për qasje në dokumente zyrtare
- 27.10.2026 – Kërkesë për rishqyrtim
- 28.10.2026 – Refuzim i kërkesës për rishqyrtim

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Nuk ka vërejtje

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ne si OE "EING COM" SH.P.K. i pasuksesshem ne kete aktivitet te prokurimit sipas vendimit te Autoritetit Kontraktues, po paraqesim kete ankes ne Organin Shqyrtues te Prokurimit sepse konsiderojm se Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar drejte dispozitat e legjistacionit per prokurim publik duke rekomanduar per kontrate nje GOE te papergjegjshem qofte ne aspektin administrativ gjithashtu edhe ne aspektin financiar.
Me poshte po i paraqesim pretendimet tona per dispozitat te cilat Autoriteti Kontraktues i ka shmangur gjate vleresimit te tendereve.

1. Neni 7
2. Neni 10
3. Neni 11
4. Neni 59

5. Neni 60
6. Neni 61
7. Neni 69
8. Neni 108/A
9. Si dhe nenet 40 dhe 41 të Rregullores nr. 001/2022, e ndryshuar dhe plotësuar.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Me datë: 22.10.2026 kemi pranuar Letrën Standarde për Tenderuesin e Pasukseshëm.
Më 23.10.2026, në orën 16:00, kërkuam qasje përmes platformës e-Prokurimi. Qasja u caktua për datën 26.10.2026, në orën 13:30.
Në qasje ne kemi kërkuar qe te na jepet kopje e materialit të OE pjesmarrës ku neve nuk na eshte ofruar i gjith materiali sepse sipas AK-se OE kane dorezuar deklaraten e konfidencialitettit sipas nenit 68-69 te LPP-së, dhe materiali tjeter na eshte dorëzuar në dy CD, ku njëra CD permban materialet e ofertave te OE:
Kompani Prishtina, Adetex, ADA CONSULTING GROUP, Global dhe QUATRO TRADE, ndërsa CD tjeter fare nuk hapet dhe nuk permban asnje dokument ku keto CD i kemi si dëshmi.
Prandaj refuzimi i kerkeses per rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues me pretekstin se ne po manipulojm me kete fakt nuk qendron sepse ne nuk jemi ketu dhe as nuk e kemi ndertuar imazhin tone si kompani serioze duke manipuluar apo keqperdorur procedurat e prokurimit publik. Perkundrazi ky Autoritet Kontrakues dhe secili Autoriteti Kontraktues mund te sheh profilin tone si Operator Ekonomik dhe te nxjerr konstatime se kush jemi ne.
Ne sipas procesverbalit te nënshkruar për pranimin fizik të materialit në CD, ai nuk e zëvendëson verifikimin e lexueshmërisë dhe plotësisë së dokumenteve. Po ashtu edhe ne procesverbal theksohet se nuk është dorëzuar i gjithë dokumentacioni.
Ne rastin konkrete Autoriteti Kontraktues do te duhej ta zbatonte drejt nenin 11 te LPP-se dhe Nenin 7 te rregullores per prokurim publik i plotesuar dhe ndryshuar me rregulloren 002/2024.
Pas kerkeses sonte per qasje ne dokumente, ashtu siq e kemi cekur edhe ne kerkesen per rishqyrtim e kemi pas te pamundur qasjen ne CD te cilen e kemi pranuar nga Auotiriteti Kontraktues dhe e cila lehtesisht mund te konstatohet se eshte e pamundur te hapet pra ndaj ky fakt na penalizon mjafte shum ne kete proces dhe na bene te dyshojm ne pergjegjshmerin e OE te rekomaduar si dhe OE tjere te pasukseshem ne kete procedur te prokurimit. Andaj, mungesa e dokumentacionit te OE pjesmarrës qoft OE te rekomanduar apo OE tjere te pasukseshem na bene te supozojm se te njejtit nuk i plotesojn kerkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate

Meqenëse AK gjatë qasjes nuk na ka ofruar të gjithë dokumentacionin e ofertave të operatorëve ekonomikë dhe nuk na ka mundësuar qasje të plotë e funksionale, ne pretendojmë, mbi bazën e supozimit të krijuar nga kjo pamundësi verifikimi, se edhe ofertat e operatorëve të vlerësuar të përgjegjshëm mund të mos i plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit. Kërkojmë që AK dhe, qe lenden ta kthej ne rivlesim duke i mar ne konsideratë këto pretendime dhe t'i verifikojnë në dokumentacionin origjinal,

përfshirë pjesët e klasifikuara si sekret afarist. Pamundësia për t'i konkretizuar më tej mangësitë buron nga kufizimi i qasjes dhe nuk duhet të trajtohet si heqje dorë nga kundërshtimi ynë.

Pretendimi Nr. 1 ndaj GOE AC Ing SH.P.K.; Decon SH.P.K.; SMART ENG GROUP SH.P.K.; TETRONIKS L.L.C.
OFERTA E REKOMANDUAR: Nuk na është mundësuar qasje e plotë dhe funksionale. Megjithate dyshojm se GOE i rekomanduar nuk i ploteson kerkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate perkatesisht listën e çmimeve, sipash pershkrimit te Autoritetit Kontraktues ku kerkohet edhe prodhuesit dhe origjina e materialeve per secilin pozicion po ashtu përllogaritjeve te paramases, planit dinamik dhe dëshmive të kualifikimit sipas dosjes se tenderit. Prandaj kerkojm nga eksperti shqyrtues dhe paneli shqyrtues ta vleresoj dhe konstatoj se i njejti nuk i ploteson kerkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate.

Rritja e sigurimit të ekzekutimit në 30% nuk mund të zëvendësojë shqyrtimin dhe arsyetimin e çmimeve sipas nenit 61 të LPP-së. Kërkojmë nga AK të verifikojë këtë çështje, të arsyetojë pranimin e ofertës dhe, nëse çmimet nuk justifikohen, ta refuzojë atë dhe ta kthejë lëndën në rivlerësim.

Pretendimi Nr. 2 - GOE: Kompania Prishtina SH.P.K.; E CONNECT AL SH.P.K.; ARAD 94 SH.P.K.
Sipas letrës standarde të eliminimit në faqen 11 të dokumentit të AK-së, në disa pozicione të listës së çmimeve mungojnë titulli i prodhuesit dhe vendi i origjinës. Pajtohemi me mospranimin e ofertës nëse këto mangësi konfirmohen sipas kërkesave të dosjes.

Pretendimi Nr. 3 - Adetex dhe REAL INVEST
Sipas letrës standarde të eliminimit në faqen 13 e identifikon këtë grup si të eliminuar dhe përshkruan llogaritje të dyfishtë të TVSH-së me diferencë mbi 2%. Pajtohemi me arsyen e eliminimit.

Pretendimi Nr. 4 -ADA CONSULTING GROUP dhe SHM Architecture
Sipas letrës standarde të eliminimit në faqen 19, mungon çmimi në pozicionin 2.7.8. Pajtohemi me arsyen e eliminimit për këtë mangësi të evidentuar dhe kërkojmë të njëjtin standard për çdo ofertë tjetër.

Pretendimi Nr. 5 ARBËRI-NS SH.P.K.; SINANI-ING SH.P.K.; GlobalBuild SH.P.K.
Sipas letrës standarde të eliminimit në faqen 29, mungon çmimi në pozicionin 13.5. Pajtohemi me arsyen e eliminimit për këtë mangësi të evidentuar dhe kërkojmë të njëjtin standard për çdo ofertë tjetër.

Pretendimi Nr. 6 MBB Construction SH.P.K.; BAJRAM HA.GASHI B.I.; EdiBau-ing SH.P.K.
Sipas letrës standarde të eliminimit në faqet 15-16, AK evidenton se plani dinamik nuk është ndarë në ditë kalendarike sipas dosjes. Pajtohemi me arsyen e eliminimit duke kerkuar qe edhe ne ofertat tjera te vlersohen sakt ne kete pike.

Pretendimi Nr. 7 Rinesa dhe FRONI 1

Sipas letrës standarde të eliminimit në faqen 17, AK evidenton llogaritje të dyfishtë të TVSH-së dhe diferencë mbi pragun 2% të përmendur në arsyetim. Pajtohemi me ruajtjen e eliminimit mbi bazën e mangësisë së evidentuar, duke kërkuar kontroll të njëjtë të përllogaritjeve te ofertat e tjera.

Pretendimi Nr. 8 NPN EUROING SH.P.K.; Euro Project SH.P.K.

Sipas letrës standarde të eliminimit në faqen 22, lista e çmimeve nuk është plotësuar në tërësi dhe mungojnë çmime në disa pozicione. Pajtohemi me ruajtjen e eliminimit për mangësitë e evidentuara dhe kërkojmë trajtim të barabartë për të gjithë ofertuesit.

Pretendimi Nr. 9 ART-EDA SH.P.K.; ALFA.i.

Sipas letrës standarde të eliminimit në faqen 25, AK evidenton mungesën e titullit të prodhuesit dhe vendit të origjinës në listën e çmimeve. Pajtohemi me ruajtjen e eliminimit për këtë mospërputhje, në përputhje me dosjen dhe rregullat e zbatueshme.

Pretendimi Nr. 10 2A Group SH.P.K.; ALKO-IMPEX-General Construction SH.P.K.
Sipas letrës standarde të eliminimit në faqe 27, në disa pozicione mungojnë titulli i prodhuesit dhe vendi i origjinës. Pajtohemi me ruajtjen e eliminimit për mangësitë e evidentuara dhe kërkojmë trajtim të barabartë për të gjithë ofertuesit.

Pretendimi Nr. 11 LIMORA SH.P.K.; R & Rukolli
Sipas letrës standarde të eliminimit në faqe faqen 32, AK evidenton mungesën e titullit të prodhuesit dhe vendit të origjinës në disa pozicione. Pajtohemi me ruajtjen e eliminimit për mangësitë e evidentuara dhe kërkojmë trajtim të barabartë për të gjithë ofertuesit.

Pajtohemi plotësisht me vleresimet e dhena nga ana e AK-së për ofertat e eliminuara të operatorëve të cilat mangësi janë evidentuara në letrat standarde nga ana e AK-së.

PRETENDIMET NDAJ OFERTAVE TË VLERESUAR SI TE PERGJEGJESHME SIPAS LETRËS STANDARDE NGA AK:
Për secilin grup më poshtë kundërshtojmë konstatimin e përgjegjshmërisë dhe kërkojmë verifikimin e dokumentacionit origjinal per arsyet e cekura me larte, ne raport me çdo kërkese të dosjes se tenderit. Pretendimi mbështetet në pamundësinë tonë të kontrollit për shkak të qasjes së kufizuar per mos te thene qe ka munguar qasja komplet.

Pretendimi Nr. 12 EBK SH.P.K.; IoT Smart & Green SH.P.K.; PRO ARK CONSTRUCTION SH.P.K.
Nuk na është mundësuar qasje e plotë dhe funksionale. Pretendojmë mospërmbushje të mundshme dhe kërkojmë kontroll të dokumentuar të listës së çmimeve dhe të të gjitha dëshmive të kërkuara sipas kerkesave te dosjes se tenderit.

Pretendimi Nr. 13 Krapi Com SH.P.K.; EURO CONSTRUCTION NNP SH.P.K.
Për shkak të qasjes jo të plotë dhe jo funksionale, kërkojmë verifikimin e përgjegjshmërisë së grupit, përfshirë listën e çmimeve, planin dinamik dhe dëshmitë e kualifikimit sipas kerkesave te dosjes se tenderit.

Pretendimi Nr. 14 AAG PROJEKT; ALPING SH.P.K.; Shkembi SH.P.K.
Nuk kemi pasur qasje të plotë dhe funksionale. Kundërshtojmë përgjegjshmërinë si të

paverifikueshme nga ne dhe kërkojmë kontroll të plotë të ofertës me të njëjtin standard të përdorur për të eliminuarit.

Pretendimi Nr. 15 H & B-Consulting SH.P.K.; Raf II SH.P.K.

Nuk na është mundësuar qasje e plotë dhe funksionale. Kërkojmë verifikimin e çdo kërkese administrative, teknike dhe të kualifikimit të zbatueshme dhe arsyetim të veçantë për rezultatin.

Pretendimi Nr. 16 Astraplan SH.P.K.; UNICRON SH.P.K.; U-UNIQUE SH.P.K.
Qasja nuk ka qenë e plotë dhe funksionale. Pretendojmë mospërmbushje të mundshme dhe kërkojmë kontroll të dokumentuar të çmimeve, planit dhe dëshmive të kërkuara në dosje.

Pretendimi Nr. 17 QUATRO TRADE SH.P.K.; Uleza Ndertim SH.P.K.
Edhe pse na eshte ofruar një pjesë e dokumentacionit të GOE ky fakt nuk nuk provon qasje të plotë. Kundërshtojmë përgjegjshmërinë dhe kërkojmë kontroll të të gjitha kërkesave, përfshirë pjesët e padisponueshme për ne.

----------perfundim i pretendimeve ankimore----------

Andaj arsyet dhe faktet e paraqitura më lartë, dhe për shkak që mos të dëmtohet interesi publik nga mungesa e marrjes së shërbimeve me kohë, dhe në anën tjetër që të ndalet dhe parandalohet dëmi serioz që është shkaktuar në drejtim të parashtruesit të ankesës duke ia mohuar të drejtën ligjore që të shpërblehet me kontratë pasi nuk ka asnjë bazë ligjore që të veprohet ndryshe, kërkojë që pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe dyshimeve tona te bazuara, kerkojm nga Organi Shqyrtues i Prokurimit të merr vendim me të cilin:

I. **APROVOHET** si e bazuar ANKESA e GOE: "EING COM" SH.P.K

II. **ANULOHET** Njoftimi i Vendimit të Autoritetit Kontraktues për Njoftim për anulim sipas formularit B58 të datës: 22.10.2026

III. **Lënda të kthehet në RIVLERËSIM** duke marrë në konsiderat të gjitha gjetjet të cilat janë lartëcekur dhe me rastin e rivlersimit të jete ne harmoni me kërkesat ligjore si dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

GOE: "EING COM" SH.P.K në mbrojtje të interesave të tij ekonomike dhe ligjore, rrjedhimisht në rast të vazhdimit të veprimeve kundërligjore do të veprojë me të gjitha mjetet ligjore të lejuara, dhe Kërkesës për kompensimin e dëmeve, duke përfshirë edhe fitimin e humbur.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Ankesës i bashkangjiten ne kopje dokumentet, faktet, provat e konstatuara me larte.